

## **Gazment BARDHI**



**Datëlindja:** 06.07.1986

**Vendlindja:**

**Email:** Gazment.Bardhi@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Gazment Bardhi është diplomuar me rezultate të shkëlqyera si “Jurist”, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2008. Në Gusht 2008 ka filluar punë si specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Në 2012 është emëruar Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë dhe më pas, në Shtator 2012, është emëruar Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, Gazment Bardhi filloi punë si Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar, për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, detyrë që e mbajti deri në Shkurt 2019. Gjatë periudhës Maj-Shtator 2017, shërbeu si Ministër i Drejtësisë, një pozicion që iu ofrua opozitës në përgjigje të krizës politike të krijuar përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017. Gjatë periudhës 2013-2018 ka qenë Këshilltar i Kryetarit të Partisë Demokratike për çështjet ligjore dhe gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë Drejtues i Departamentit të Drejtësisë në Partinë Demokratike dhe ex-officio anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike.

Në 19 Janar 2019 Gazment Bardhi është zgjedhur nga Këshilli Kombëtar si Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë, detyrë që e ushtron deri aktualisht. Në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 është zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nga lista shumëemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë në qarkun Elbasan.